

Bardhyl Demiraj
(LMU Munih/RFGJ)

“Dotrina e Kershten” (1845) e P. Zef Guagliata-s – një rast studimi filologjik

*“Besa une, si flasim shqipen n’ Shkodër,
ashku me t’ paken forc temen jam munue me
shkruie, ... tuj baa gajzet edhe ç’ fjalë, ç’
knohen ktu, t’jeen marrun vesht prej
Shqyptarit oçm.”*

(E. Radoja 1872 6)

Objekti i studimit me diskutimin përkatës

E njohim pak, shumë pak, e shumëkush aspak! Në këtë përfundim erdhëm dikur natyrshëm, kur shfletonim në sallën e leximit të Arkivit Qendror të Shtetit (AQSH – maj të vitit 2013) atë kopje të cungët – në mos të vetmen në Shqipëri! – të botimit të parë të /Dotrina e Kershten [e] Kardinallit Bellarmino t’ Shoqniët Jesus-it. Ksiellun n’shqyp prej P. Zefit Guagliata t’shoqniët e vet. N’Rom [...] 1845/¹. Një kopje të saj të dytë, por të plotë, patëm fatin ta shfletonim rishtas po në një sallë leximi, bash në atë të Bibliotekës Apostolike të Vatikanit (mars 2015), me synimin e thjeshtë dhe dëshirën e mirë vetëm e vetëm me u përditësuar me plotësinë e atij botimi. Ngulmojmë fort në këtë detaj, meqë ky doracak dygjuhësh italisht dhe shqip, mund dhe duhet të jetë qenë bërë motmoti vërtet fort i rrallë, meqë do kohë pas botimit të tij të parë, në një qark kohor prej thujtë dhjetë vjetësh e pason botimi i dytë (Romë 1856), e jo më larg se 17 mote të tjerë edhe i treti, si gjithnjë me shtampë <T’Shëtitit Kuvën te Propaganda Fide> në Romë (1873).²

Prashtu dy ribotime të njëpasnjëshme të së njëjtës vepër, brenda një periudhe relativisht të shkurtër, dëshmojnë qartë kumtin mirakandës të përkthimit të saj shqip; e në këtë rast nuk mund të mos mbajmë parasysh edhe faktin, që ky doracak nuk ishte assesi i vetmi libër mësimi doktrinar mbi fenë e krishterë që ndanin e shpërndanin atëbotë barinj të Kishës Katolike-Romake për të mbarështruar dhe përkujdesur grigjat e veta në Veri të Shqipërisë.³

¹ Titulli original i veprës shqip: <Dotrina e Kershten / Cardinallit Bellarmino / t’ Sciochniët Jësus / Ksiellun n’schiyp / prei P. Zefit Guagliata t’Sciochniët Evet. N’Rom. Te Stampuëm t’ Scëtitit Cuvën de Propaganda Fide. 1845>; dhe italisht: <Dotrina Cristiana del Card. Bellarmino della Compania di Gesù. Tradotta in Albanese dal P. Giuseppe Guagliata della medesima compania. Roma. Coi tipi della S. C. de Propaganda Fide. 1845> 288 f.

² Shih Markus W. E. Peters: Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur. Die “Buchdruckerei der Unbeflecten Empfängnis” zu Shkodra (1870-1945), Hamburg 2007 531. Një kopje të botimit të tretë patëm fatin ta konsultojmë në origjinal në Bibliotekën “Gjergj Fishta” të Urdhërit të Françeskanëve Minorë në Shkodër.

³ Budi 1868⁽⁴⁾ [Titulli i botimit (të parë): <Dotrina Christiana. Composta per ordine della fel.me di Papa Clemente VIII. Dal R.P. Roberto Bellarmino Sacerdote della Compania di Jesv. Adesso Cardinale di santa Chiesa del Titolo di S. Maria in Via. Tradotta in lingua Albanese dal Rever. Don Pietro Bvdi da Pietra Biancha. In Roma, Per Bartolomeo Zannetti 1618>]; Engjëll Radoja: <Dotrina e Kershten me msime e spieghime ci egoç e i mloç scciyp Dom Egnell Radoja, prift i Arcidiocesit Sckodrs. N’Sckoder 1876>; më vonë Nnre Logoreci: T’mleçunit e Dotrins Kscstën daa n’kater ört, sckruie prei mesctarit D.A. Ferrari e siehun scciyp prei Dom Nnre Logorezzit, prift i Arcidiocesit Sckodrs. N’Rom [...] 1886> (botimi i dytë: 1895²).

Asgjëmangut ky doracak do parë e kundruar sot thjesht dhe vetëm si pjesë e asaj tradite të frytshme të librit katekistik në gjuhën shqipe që u botua në vazhdimësi e me syzim përhapjen e tij në Provincën Kishtare të Arbënisë si edhe në Arqipeshkvinë e Shkupit në shekujt XVI-XVIII (Budi 1918, 1636⁽²⁾, 1664⁽³⁾; Kazazi 1743⁽⁴⁾)⁵ e sidomos përgjatë gjysmës së dytë të shek. XIX (Budi 1868⁽⁴⁾; Engjëll Radoja 1876; Nnre Logoreci 1886, 1895⁽²⁾ etj.), andaj as nuk qesëndisim dhe as nuk lëndojmë pendën dhe autoritetin e autorit tonë, në qoftë se mëtojmë që në hyrje të këtij studimi, që në shumë pamje ky botim mund dhe duhet vështruar tashmë i kapërcyer në funksionin e vet zanafillës si libër mësimi doktrinar. Një fakt historik-kulturor na josh gjithsesi drejt një këndvështrimi tjetër në studimin tonë. Bëjmë fjalë këtu për vëzhgime me karakter të mirëfilltë filologjik, sidomos të shtampës së parë të kësaj doktrine. E për këtë na ndihmon natyrshëm një përllogaritje fare e thjeshtë, thujtë triviale, përgjatë boshtit kronologjik në kulturën e shkrimit shqip, ku dhe kur kjo vepër – siç jemi të mirinformuar deri më sot! – rezulton të jetë ndër të parat botime deri diku solide në shek. XIX me orientim arealin kulturor të Veriut (katolik) shqiptar.⁶ Sa domethënës aq edhe bindës në ndërmarrjen e këtij hetimi është padyshim edhe një kumt

⁴ Titulli original italisht i botimit: <Breve compendio della Dottrina Cristiana. Tradotta in lingua albanese per l'utilità, e istruzione dei Fanciulli di questa Nazione. Da un Nazionale del Regno di Servia [Gjon Nikollë P. Kazazi = Johannes Baptista Nicolouich Casasi – B.D.]. Allunno della S. Congregazione. in Roma MDCCXLIII. Nella Stamperia della S. Congr. de Propaganda Fide. Con licenza de' Superiori>.

⁵ Elemente të katekizmit i ndeshim në fakt qysh në "Mesharin" e Gjon Buzukut 1555 (shih Markus W. E. Peters: Die liturgisch-Katechetische Handreichung des D. Gjon Buzuku vor dem theologiegeschichtlichen Hintergrund des Konzils von Trient, në: "Nach 450 Jahren. Buzukus "Misale" und seine Rezeption in unserer Zeit" (bot. B. Demiraj), në radhohën "Albanische Forschungen" nr. 25; Wiesbaden 2007, 235vv.); ndërkohë që për disa botime e dorëshkrime sot të panjohura katekizmesh shqip me destinacion arealin në fjalë kumtojnë kryesisht burime dytësore, siç është p.sh. rasti i botimit të një doktrine me tirazh 500 kopje në vitin 1584 (shih: Giuseppe Valentini: Elementi romano-cattolici nella cultura albanese, në: "Civiltà Cattolica", 1941, bl. II, f. 45; hollësisht për këtë katekizëm shkruan së fundi Matteo Mandalà: Su un catechismo in albanese della seconda metà del '500. Prime ipotesi e questioni preliminari per una futura ricerca (2015 – në shtyp); një tjetër katekizëm që paska njohur madje edhe një ribotim, ka për autor misionarin italian Bernardo da Verona dhe donator Imz. Pjetër Bogdanin (shih ndër të tjerë Eqrem Çabej: Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre, në: "Studime Gjuhësore" bl. VI, Prishtinë 1977 (1959) 329vv. apo vepra e mbetur pas gjase në dorëshkrim e me autor misionarin françeskan Át Francesco Maria da Lecce (shih Gëzim Gurga: Át Francesco Maria da Lecce. Dittionario Italiano – Albanese (1702). Botim kritik [...], Shkodër 2009, f. 35). Për autorë të tjerë si Budi e Kazazi shih shën. nr. 3, 4.

⁶ Të njëjtin vit botimi ka edhe libri më pak i vëllimshëm sivëllait jezuit P. Vincenzo Basile-s: <Ruga e Parrisit, calzuem kerstenvet Arbniis prei P. Vincenzit Basile t' Sciochniet Jesus. Rom [...] 1845>, 144 f.

Në këtë rast lëmë përkohësisht mënjandë ndonjë tekst të shkurtër, qoftë ky në dorëshkrim ose i shtypur ashtu kalimthi në shtypshkronjën e Propaganda Fide-s në Romë. Bëjmë fjalë këtu sidomos për një botim, të mbetur deri sot i panjohur, që bibliografitë albanologjike e kumtojnë gjithkund me vitin 1828 si vit botimi, e që përmbante dikur vetëm 2 fletë në formatin 8°: <Pun t'nevoisem me u dytun per me scelbue scpjrtin etc. Romae 1828. Ex Typis S.C. de Propaganda Fide>. Burimin e parë bibliografik e jep Franz Miklosich (: Albanische Forschungen I. Die slavischen Elemente im Albanischen, mit einer Einleitung [...] von Dr. Franz Miklosich [...] Wien 1870, f. 6) e pas tij sipas rastit bibliografë të mëvonshëm, që i referohen (ose jo) këtij botimi pa ndonjë të dhënë tjetër shtesë, madje edhe në kuptimin, nëse i kanë kaluar dikur nëpër duar këto dy fletë.

plotësues, pikërisht ai që botimi paraprijës po aq solid e me shtampë po të Propaganda Fide-s i takon bash vitit 1743, pra thuhet një qindvjetëshi më herët, kur doli në dritë dhe u shpërnda ndër besimtarët katolikë shqiptarë simotra e llojit të vet, e cila bart jo rastësisht të njëjtin titull (të brendshëm) /Doktrina e Kërshten. E nevojshime gjithtësillit kërshten për të shëlbom/ (Romë 1743),⁷ dhe me autor – përkthyes dhe përshtatës – Imzot Gjon Pagëzues Nikollë Kazazin prej Gjakovë në Rrafsh të Dukagjinit.

Mjaftojnë këto dy kumte domethënëse me sinorët motnorë përkatës për të na joshur e nxitur me hetuar në detaj këtë vepër, sa i përket vendit të saj në historinë e kulturës së shkrimit shqip, sidomos në arealin kulturor shqiptar të Veriut katolik në shek. XIX, domethënë në bashkëlidhje me atë traditë dhe ato risi që përshkoi natyrshëm e në vazhdimësi “Alfabeti i Shkodranishtes së Vjetër” (Rrota 1936 69⁸), ase i ashtuquajturi “Alfabet i Propagandës” (Demiraj 2008 50⁹); një traditë kjo që zuri rrënjë e hodhi shtat me sistemin grafik të përdorur – në mos të zhvilluar për të parën herë! – thuhet tre shekuj më herët (më 1555) prej birit të Bdekës, Don Gjon Buzukut dora vetë.

Saktësuam kështu thukët synimin tonë modest në këtë studim, me dëshirën dhe shpresën e mirë se mund të nxisim në një të ardhme të afërt kërkime të mirëfillta arkivore lidhur me rrethanat e përfutimit të veprës, e cila rezulton të jetë ndër të pakat në historinë e kulturës së shkrimit shqip që njohu tri botime radhazi në një periudhë relativisht të shkurtër.

Autori dhe mjedisi historik-kulturor i veprimit të tij

Sa i përket autorit të veprës, P[ater] Giuseppe Ignazio Guagliata (= shq. P. Zef Ign. Guagliata), na duhet të përsërisim dhimbshëm të njëjtin kumt që sinjalizuar qysh në hyrje, madje qysh në fjalinë e parë të studimit tonë: *E njihnim pak, shumë pak e shumëkush aspak!*, pra, me një ndryshim në dukje pa rëndësi, sa i përket vetëm përshtatjes së kohës (gramatikore), përkatësisht rrethanave aspak fatlume që përjeton me kohë e sidomos ndërkohë debati intelektual-albanologjik në hapësirën kompakte shqipfolëse. Padyshim që për autorin tonë, sikurse për shumë e shumë autorë, klerikë e intelektualë të Shqipërisë së Veriut nuk lejohemi assesi të përdorim si kut matës – qoftë edhe moralisht!!! – praninë ase mungesën e tij si zë i veçantë, sado i vockël, në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar” e aq më pak në ribotimin sa të zgjeruar aq edhe jofatlum! në plot tri vëllime (ASHSH, Tiranë 2008-2009), në të cilin jo rastësisht në njërin ndër faqet e prapme të frontespicit citohet si redaktor përgjegjës filologu në pension, profesor doktor Emil Lafe dora vetë¹⁰.

⁷ <Doctrina e Kërshten. E nevojshime gjithtësillit kërshten për të shëlbom> (f. 5). Shih edhe shën. 4.

⁸ Rrota, Justin: Per historin e alfabetit Shqip. Pasqyra e shembuj per shkolla të mjesme. Shkoder 1936.

⁹ Demiraj, Bardhyl (bot.): Dictionarium latino-epiroticum per R.D. Franciscum Blanchum, Shkodër 2008.

¹⁰ Këmbëngulim fort në këtë cilësi profesionale të redaktorit tonë, me shpresë se do të mbahet parasysh në botimin e tretë të këtij fjalori, meqë në botimin e tij të dytë feks zëri i LAFE, Emil (1938- [–pa fotografi bardhezi – B.D.]) me plot 40 rreshta, por i mëshohet fort, shumë fort, vetëm angazhimit të tij social-intelektual si ish-humboldian i vonuar dhe pjesëmarrës në një tubë komisionesh zyrtare, sikurse edhe si kryeredaktor i revistës ndërkohë fantazmë “Gjuha Jonë”.

Për të mësuar sado përciptas diçka mbi autorin tonë, jemi të detyruar gjithsesi të shfletojmë letrat e mëhershme albanologjike. Dhe rezultatet janë sa modeste aq edhe të joshëse, meqë autorin tonë së bashku me veprën e tij i hasim në kodikët e historisë së albanologjisë kryesisht të regjistruar kalimthi e vetëm në ndërmarrje me karakter bibliografik të kohës: Miklosich 1870 6, Meyer EWA 1891 521, Maneck-Pekmezi-Stotz 1909 27 etj.¹¹ Diçka më shumë mëton thujtë këtu e 40 vjet më parë Shuteriqi (1976 245¹²), i cili rezulton të ketë qenë deri sot ndër të pakët, në mos i vetmi bibliograf që ka shfletuar e shkruar dikur (mbi) ksomblën e vetme e të cungët të botimit të parë të doktrinës së Guagliata-s në AQSH, paçka se kjo vepër atij – në përputhje me idealet dhe ideologjinë e kohës, në dhe për të cilën nuk i reshti penda së punuari me stimë të veçantë – i rezulton më fort si pjellë e “urdhrit famëkeq”, thënë saktë, e Shoqërisë së Jezusit (në Shqipëri).

Sa i përket emrit të Zef Guagliata-s në historiografinë e Kishës Katolike-Romake në Shqipëri, punët – edhe pse ndryshojnë disi –, nuk e lehtësojnë aspak, përkundrazi e rëndojnë edhe më shumë barrën e rëndë të detyrimit moral në projektet shqiptare me karakter enciklopedik albanologjik për t'i shtuar një sinor më shumë rrjedhës së kulturës së shkrimit shqip sikurse historisë së kulturës shqiptare në përgjithësi.¹³ Prashtu, ndër ata pak studiues që janë marrë sado shkarazi me emrin dhe angazhimin misionar të Patër Zef Ign. Guagliata-s në Shqipëri dallojmë këtu sidomos shkrimin e patëmetë të Nestorit të Kulturës Shqiptare në mërgatën (kulturore-politike) të gjysmës së dytë të shek. XX, që vjen me thënë të ish-rektorit të Kolegjit Saverian në Shkodër, Patër Zef Valentini-t S.J. dora vetë.¹⁴ Një përfytyrim deri diku kompakt e fitojmë gjithsesi në punën e ngulmët të Ines A. Murzakut, e cila ka hulumtuar në themel bëmat kulturore-historike e assesi famëkeqe të Urdhrit Jezuit në Shqipëri përgjatë periudhës 1841-1946.¹⁵ Prej tyre mësojmë hollësisht se caku i parë kohor i këtij ngulimi është i lidhur pazgjidhshmërisht me emrin e P. Zef Guagliata-s – i njohur në letërsinë albanologjike edhe si <Quagliata> –, si njëri ndër tre pinjollët e atij urdhri që la zyrtarisht gjurmët e para në Shkodër, bash në prill të vitit 1841 e me pikësynimin dashamir me sendërtuar njëri ndër ndërmarrjet afatgjata që mëtonte motmoti Kongregacioni i Shenjtë i Propaganda Fide-s për përkujdesjen dhe përhapjen e krishtërit (edhe) në hapësirën kompakte shqipfolëse e ndërkohë edhe Perandoria e Austro-Hungarisë në kuadrin e Protektoratit Kulturor (= gjerm. *Kultusprotektorat*) të Veriut të Shqipërisë, kryesisht të asaj shtrese sociale të

¹¹ Shih ndër të tjerë: Franz Miklosich: Albanische Forschungen I: Die slavischen Elemente im Albanischen. Mit einer Einleitung. Wien 1870; Gustav Meyer: Albanesisches Etymologisches Wörterbuch, Leipzig 1891; F. Manek & Gj. Pekmezi & A. Stotz: Albanesische Bibliographie. Wien 1909.

¹² Dhimitër Shuteriqi: Shkrimet Shqipe në vitet 1332-1850. Tiranë 1976. Ndonjë hollësi të mëtejshme lidhur me fillimet e Urdhrit të Shoqërisë së Jesus-it në Shqipëri si edhe përmendjen e autorit tonë në letërsinë ekleziastike të kohës shih së fundi Markus W. E. Peters *vep. cit.* [Quagliata, Giuseppe S.J.] f. 51, 64, 108, 110, 297, 531.

¹³ Insistojmë fort në këtë truall, sepse Patër Zef Guagliata – s'donte apo s'dinte redaktori dhe filologu specialist i Fjalorit “të ri” Enciklopedik Shqiptar!!! –, është padyshim pjesë e kësaj kulture.

¹⁴ Giuseppe Valentini: La missione dei gesuiti e la cultura albanese”, në: “Spiritualita” 1974, 18.

¹⁵ Ines A. Murzaku: Catholicism, Culture, Conversion: The History of the Jesuits in Albania (1841-1946), në radhøjën: “Orientalia Christiana Analecta” nr. 277., Roma 2006, 67vv.

popullsisë shqiptare që i takonte besimit katolik. Bëjmë fjalë këtu për hapjen e një shkolle e më pas edhe të një seminari teologjik, të drejtuar prej Urdhrit Jezuit, si urdhër i mirënjohur gjithkund në Perëndim për programin e vet mësimor (*ratio studiorum*) dhe metodën didaktike unike të formimit akademik-intelektual.¹⁶ Pa dashur të shtojmë aspak dozën e sarkazmës së fatit, lejohemi të shtojmë vetëm, që ishte bash kjo ndërmarrje fanmirë që iu kthye vetë misionit si bumerang ogurzi: Jo më larg se gushti i vitit 1843, pra diçka më shumë se dy vjet pas ngulimit të tij të parë në Shqipëri, duke përfshirë këtu edhe gjashtë muaj ngujimi në ambientet e banimit të zëvendës-konsullit austriak, Vincenzo Ballarini-t – për t'i shpëtuar së ashtuquajturës “revoltë popullore”, e cila përjetoi si pikë kulmore shkatërrimin në themel të ndërtesës së porsapërfunduar që ishte parashikuar si seminar jezuit –, Zef Guagliata u detyrua “t'i linte pendët” një herë e përgjithmonë Dheut të Shqipëses. Gjithsesi dy vjet më pas u kthye në Shkodërloce kumti i tij, “Doktrina e Kershten” që u botua në Romë nën përkujdesjen e Vincenzo Basile-s (shih më poshtë).

Për fatin e tij pas këtij fati të pafat dimë pak, shumë më pak sa ç'dinim dikur edhe për jetën dhe formimin e tij para ardhjes në Shkodër. E për këtë fazë të parë na mëson sado përciptas nestori albanolog, Zef Valentini (1974), i cili me portretizimin që i bën këtu e 40 vite më parë, zbret në tokë vetë personin e Zef Guagliata-s, përkatësisht – në bashkëlidhje me objektin tonë të studimit – i jep dum pyetjes-çudi ase përgjigjes-mrekulli, se si dhe qysh Zef Guagliata ishte në gjendje që brenda një periudhe jo më larg se dy vjet arriti të njëjtte shqipen aq mirë sa të mund të përkthente po aq lirshëm dhe besueshëm një libër doktrinar të fesë katolike-romake. Dhe përgjigja është sa e thjeshtë aq edhe tokësore: Zef Guagliata vinte në Shqipëri, sikurse sivëllai i vet Vincenzo Basile, prej provincës jezuite të Sicilisë (pjesë e Mbretërisë së dikurshme të Dy Sicilive). E ndërsa për lirin e tij të gjakut kërkon por s'gjen të dhëna faktike – fundorja -a e mbiemrit familjar vetëm sa na josh të bëjmë ndonjë përsiatje të guximshme për një zanafillë të mundshme arbëreshe! – për lirin e tamblit mësojmë prej tij shumë më shumë: kemi të bëjmë në këtë me dell të mirëfilltë arbëresh, meqë e ëma e Zefit tonë rridhte prej familjes së njohur arbëreshe Marchese në Palermo.¹⁷ Prashtu, ky kumt e përforcon tash përsiatjen, se Guagliata ndoshta e kishte mësuar qysh fëmijë gjuhën e nënës, arbërishten, pra të kishte pasur të rrënjosura qysh në fëmëni njohuritë bazë për këtë gjuhë si një folës i saj natyror. Asgjëmangut qëndrimi i tij fare i shkurtër në Shqipëri (1841-1843), çka e shkurton edhe më shumë fakti që vepra e tij të ketë qenë përfunduar para dhjetorit të vitit 1842 (shih më poshtë) e bën më se të pranueshëm opsionin, që ky arbërishtfolës i dikurshëm të kishte qenë përgatitur e stërvitur me kohë edhe në punë të letrave

¹⁶ Si homazh ndaj këtij urdhri famëmirë dhe programit të tij mësimor shembullor lejohemi të përmendim këtu, se shumë ndër lëvruesit e moçëm të shqipëses – ndër ata që njohim deri sot: Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Gjon P. Nikollë Kazazi, Gjergj Radovani – kanë zhvilluar me sukses bash këtë program në Kolegjin Ilirik të Loretos si edhe në Kolegjin Urban të Romës.

¹⁷ Shih Ines A. Murzaku, *vep. cit.* f. 68.

shqip që qarkullonin atëbotë me destinacion arealin kulturor të Veriut katolik shqiptar.¹⁸

Vepra, përmbajtja dhe organizimi i saj

Largimin turravrap prej Dheut të Arbënit shkruesi i këtyre radhëve e mësoi ndërmjetshëm prej sivëllait të tij po-jezuit, P. Vincenzo Basile-s, në parathënien e librit të tij, të botuar po në Romë dhe në të njëjtin vit (1845, f. 3, 5), si vijon:

/Nonse une me shoqt e mī [= P. Zef Guagliata-n – B.D.] jam largue, tash jan dy vjet, prej jush e prej Arbnīs, pro nuk kam harrue njimen as jū, as nevojt tuja. Oh!, se mujshni me dit, sa kam lut tuj kjā përpara Jezu Krishtit e Zojes e bēkueme per me lyp shka ju dishroni per t’ mir shpirtnavet tuj e per mâ t’ madhen lumnīn [e] Zotit [...]/ (f. 3)

/N’ dit 25 t’ marzs, n’ vjet 1845/ (f. 5)

Basile na përcjell në parathënien e veprës së tij edhe atë informacion të vetëm që njohim deri sot lidhur me rrethanat e botimit të doktrinës së Guagliata-s, meqë, siç cekëm më lart, është ai vetë që ka asistuar dhe është përkujdesur për mbarëvajtjen e botimit të saj në shtypshkronjën e Propaganda Fide-s në Romë. Prashtu, sipas tij:

/Per me ju ngushllue edhe prej s’ largut, n’ at ças qi kam mri ktu n’ Rom menova shpejt me bâ me shtampue doktrinen e kershten, aq dishrue prej jush, e q’ ishte shkruie me shum dashtni prej shokut tem P. Zefit Ign. Guagliata. [...]/ (f. 4)

Vetë botimi i doktrinës daton vitin 1845, ndërsa hartimi dhe përgatitja e saj janë padyshim të mëhershme, të paktën tre vjet më parë, e për çdo rast para datës 10 dhjetor të vitit 1842, kur censori i saj, D[on] Pal Ramadani (= <D. Paulus Ramadani>), Pro-Vikar i Përgjithshëm (i Dioqezës së Shkodrës) shkruan referencën vendimdhënëse lidhur me saktësinë dhe vlefshmërinë e tekstit shqip, sa vijon:

“Ego infrascriptus examinavi *hanc doctrinam christianam* idiomate epirotico conscriptam, et fidem facio me illam invenisse adamussim respondentem textui italico e fronte posito.

Datum Scodrae die 10 decemb. 1842.

Loco & sigilli

D. Paulus Ramadani

Pro-Vicarius Generalis.” (f. 288¹⁹)

Përpos këtij citimi gjejmë të nevojshme me shtuar se lidhur me qëllimin, përkatësisht syzimin kryesor të kësaj vepre, titulli i saj nuk kumton gjithçka. Sigurisht që nëpërmjet tij mësojmë në radhë të parë që libri është i natyrës

¹⁸ Ndër të dhënat biobibliografike shtesë që jep ndaj personit të tij Ines A. Murzaku (në veprën e cituar), vërejmë se Guagliata hyri në urdhrin Jezuit në vitin 1827, në moshën 16 vjeç (f. 68), çka na lejon të mëtojmë vitin 1801 si vitlindje të tij. Këqyrje dhe hulumtim të mëtejshëm kërkon informacioni i dhënë prej autores në f. 254: “Giuseppe Guagliata, who only knew old Italo-Albanian or Arbëresh, before his arrival, prepared an Albanian grammar to facilitate the learning of Albanian for other missionaries serving in Albania. Then he prepared an Italian grammar and a speller; Propaganda Fide printed both works.” Një ndërmarrje e tillë – mbetur në dorëshkrim? – nuk njihet deri sot në historinë e kulturës së shkrimit shqip.

¹⁹ Përpos këtij gjykimi kemi në këtë faqe edhe lejën e botimit (*imprimatur*), të sigluar prej Fr[at] Dominicus Buttaoni O.P.S.P.A.M dhe Joseph Canali Archiep. Colossens. Vicesgerens.

katekistike, d.m.th. i shërben njohjes dhe mësimin ndër besimtarët katolikë shqiptarë të doktrinës së krishterë, në versionin e saj të shkurtër, ashtu siç e kishte përpiluar dhe hedhur dikur në letër penda dhe autoriteti i mirënjohur i Kardinalit Roberto Bellarmino S.J., kryevepra e të cilit – “Doctrina Christiana” – qoftë në versionin e saj zgjeruar, ashtu edhe në atë të thjeshtuar (d.m.th. për fijanët e pagëzuar deri para marrjes së sakramentit të Kungimit) – ka shërbyer si vepër model për përkthime edhe në gjuhë të tjera, pra edhe në përkthime e përshtatje përkatëse në gjuhën shqipe, si p.sh. botimi i disahershëm i Budit (1618, 1636, 1664, 1868). Andaj nuk kemi përse bëjmë çudi aspak lidhur me vlerësimin që i bën autori ynë Kardinalit Bellarmino, madje qysh në fjalinë e parë të vëzhgimeve të tija hyrëse në vepër:

“Kjo Doktrinë e Krishterë është një kompendium i të madhit e të shumëlëvduarit Kardinal Roberto Belarmino-s, duke i shtuar për më tepër ndonjë pikë esenciale të fesë sonë të shenjtë, siç e kërkojnë nevojat shpirtërore të kombit, për të cilin është destinuar.” (<Avvertimento>, f. 8)²⁰

Këtij qëllimi thelbësor i pranëvitet vetiu edhe një i dytë, jo më pak i rëndësishëm: në varësi me njohuritë gjuhësore të gjakojve shqipfolës, por edhe të përdoruesve të tjerë – sidomos të mësuesve (qofshin këta edhe) misionarë të huaj që do ta përdornin këtë libër si tekst mësimi doktrinar –, vetë teksti është konceptuar në dy gjuhë, të cilat i vihen ballafaqe njëra-tjetrës. Në këtë mënyrë teksti italisht dhe shqip do të shërbente njëherësh edhe si tekst mësimor për njohjen dhe përvetësimin e njërës apo tjetrës gjuhë: shqip dhe/ose italisht. Këtë synim të dytë autori e qartëson sidomos në paragrafin ndjekës të vëzhgimeve të tija hyrëse:

“E meqë, përpos priftërinjve vendas, edhe misionarët e huaj kanë për detyrë ta japin mësim, [doktrina – B.D.] është shkruar në shqip dhe italisht, andaj munden që me gjuhën që njohin, të përqasin atë që duan të mësojnë.” (“Avvertimento”, f. 8)²¹

Sa i përket përmbajtjes dhe organizimit të veprës, ato i shkojnë tamam përshtat një doracaku të kohës për përdorim të përgjithshëm, pra edhe mësimor. Bëjmë fjalë në këtë rast për një libër me formatin 12°, me një tekst që mbulon në tërësinë e tij një vëllim prej plot 288 faqesh e me një numër rreshtash që rrallëherë arrijnë shifrën 30 për faqe. Po të lëmë përkohësisht mënjanë rubrikën e dytë: <Avvertimento> (f. 8-11), së cilës do t’i përkushtohemi në detaj më poshtë (§ ...), vepra hapet me *Përkushtimin* (: it. <Dedica> f. 4v. ~ shq. <T’Consecruomit> f. 5v.) ndaj apostullit Françesk (K)saverit (= <Apòstullit t’Indit Francèsk Xavèri>) “që ndriçon mendjet e besimtarëve katolikë dhe kthen në rrugën drejt besimit të vërtetë të pafetë”; duke vijuar me *Ndjesën* (it. <Indulgenze> f. 10 ~ shq. <Nniësse> = /niese/ f. 11), ku lexuesi fatlum i doktrinës, sipas Papa Palit të 5-të /fiton niesen e njiqin ditvet/, ndërsa /Shêjti At Pap Clement i

²⁰ “La presente dottrina cristiana è un compendio della grande del tanto lodato cardinale Roberto Bellarmino, aggiunto bensì qualche punto essenziale di nostra santa fede che sembra richiedersi dalle spirituali necessità della nazione, cui è destinata.”

²¹ “E poiché, oltre i parrochi indigeni, anche i missionari stranieri debbono per uffizio insegnarla, è scritta in albanese e in italiano, onde possano con la lingua, che sanno confrontar quella che vogliono apprendere.” (f. 8)

Dymdheti dha niesen e shtat vjetvet e shtat her katerdhet ditvet gjithkujt qi nin katekizmin, o spigon, o asht përpara dotrins e kershten; edhe niesen e plot n' festat e Kshnellavet, e Pashks e t' Shêjtnavet apostujt Pjetrit e Pâlit/.

Këto premtime e siguri për *Ndjesë* i pason *Hyrja* (: it. <Introduzione> f. 12vv. ~ shq. <T' Himitt> f. 13vv.), ku jepet përmbledhtas përmbajtja e veprës, që përbëhet prej katër pjesësh, ndër të cilat, tri të parat sheshtojnë kryesisht njohjen dhe përvetësimin e tri virtyteve hyjnore (= teologale): I. Feja (si besim hyjnor: <fee> /fē/, f. 21-50); II. Shpresa (= <Scpness> /Shpnes/, f. 51-106); III. Të Dashurit (= <I Dasctunit> /I Dashtunit/, f. 107-172); ndërsa pjesa e fundit përditëson nxënësin me IV. Veprat e mira (= <Opere buone>, f. 173-285), përkatësisht me shmangien e vetëdijshme ndaj aso sjelljesh mëkatuese, të cilat i dënon kisha dhe e drejta kishtarë.

Tri virtytet hyjnore i shërbejnë Guagliata-s si pikënisje për të kumtuar, shpjeguar dhe mësuar lehtë e natyrshëm lutjet themelore si edhe ndalesat bashkë me këshillat si bazamente të doktrinës së krishterë: I. Feja: *Besoj* (= lat. *Credo*); II. Shpresa: *Ati Ynë, Falemi Mari, Engjëlli i Tinzot, Falemi Mbretëreshë, Rruzare, Engjëlli – Rojë e Shenjtë e Emrit të Vet*; III. Të Dashurit: *Dekalogu, Urdhërimet e Kishës së Shenjtë, Këshilla*; ndërsa pjesa e katërt IV. Veprat e mira përfshijnë: a) Raste kur fitohet hiri i Tinzot: *Sakramentet, Virtytet, Dhuntitë e Shpirtit të Shenjtë, Lumënitë, Vepra e Mëshirës*; b) Raste kur birret hiri i Tinzot: *Mëkatet, Mëkatet mortore* (= /huqet kapitale/); dhe c) Raste për t'u mbajtur në hirin e Tinzot, e së fundi *Përfundime* (= <Mrame>).²² Vepra mbyllet me gjykimin e censorit D[on] Pal Radovani dhe lejën e botimit (= <Imprimatur>).

Traditë dhe risi në kodin alfabetik dhe normën ortografike që zbatohet në vepër

Në rast se i anashkalojmë tash hetimit dhe vlerësimin të veprës lidhur me mënyrën e organizimit të tekstit, përkatësisht gjykimin mbi vendin e saj në historinë e letërsisë eklesiastike në gjuhën shqipe (të shek. XIX), e bëjmë këtë në mënyrë të vetëdijshme e thjesht dhe vetëm për mungesë të kompetencës sonë profesionale në një fushë që ka mbetur deri sot djerrë në historinë e kulturës shqiptare. Kjo mangësi urojmë gjithsesi të mos diktojë sadopak bjerrjen e interesit ndaj kësaj vepre në një tjetër drejtim, shi në atë të punës së mirëfilltë filologjike me tekstet e hershme shqipe dhe në historinë e kulturës së shkrimit shqip në përgjithësi, fusha këto që po lëvrohen me intensitet të veçantë këta dhjetëvjeçarët e fundit. Vëzhgimet tona u përqendruan kështu natyrshëm vetëm në këtë hulli studimi, duke u fokusuar paraprakisht në pikëlidhjet e mundshme të tekstit shqip të kësaj vepre me traditën e shkrimit shqip me alfabet latin në arealin e Veriut katolik shqipfolës, gjë që na lejoi më pas me qëmtuar po aq natyrshëm ndonjë risi që mund dhe duhet të ketë ndërmarrë – në mos ndjekur me besnikëri (?) – autori ynë, sa i përket kodit alfabetik, përkatësisht normës ortografike sado rudimentare të së ashtuquajturës *Koine Letrare*

²² I. Feja: <Bessòim> (= *besoj*, lat. *Credo*); II. Shpresa: <Atyne>, <Fàlemi-Mrii>, <Êgnli Tineòt>, <Fàlemi-Reghinèscia>, <Ruzàre>, <Êgnli roisi e Scêit emnit vet>; 3) <I dàsctunit>: <Decàloghi>, <Urñnime scêites Kisc> <Kscille>; ndërsa pjesa e katërt 4) <Opere bune> (= "vepra të mira) përfshin: <Sebete me fitue hirin e Tineòt> (= <Scramene; <Virtyte, Eumtîi t' Scpirtit scêit, Lumnii, <Vepra e miscirèrs"); <Sebete per t' ziAt bierret hiri Tineòt (= <Mcate>, <Hukie t' capital>); <Sebete per m' u mmâit n' hir Tineòt> e së fundi <T' mrame".

Gege, ase *Gegnishte Letrare* në gjysmën e shek. XIX, bash ashtu siç na pasqyrohet ajo në këtë vepër.

Vëzhgimet tona në këtë drejtim i ndihmoi dhe lehtësoi gjithsesi bindshëm e shterueshëm vetë kumti i autorit tonë, Àt Zef Guagliata-s në vërejtjet që i paraprijnë tekstit të doktrinës, të cilat po ia përcjellim lexuesit në përkthimin tonë të lirë (*ad sensum*), si vijon:

“Sa i përket shqiptimit të shqipes, [ai] realizohet pikërisht ashtu siç shkruhet, duke vërejtur për më tepër, që:

1. Theksi i rëndë (˘) shërben për theksimin e fjalëve shumëerokëshe, ndërsa majërrethori [= “circonflesso”] <^> parakupton hundorësinë e sipas rastit edhe gjatësinë e asaj zanoreje, mbi të cilën shënohet. Kur përkojnë së bashku në një fjalë, ata ushtrojnë të dy funksionin përkatës; edhe pse është vetëm theksi majërrethor, [ai që] mbulon të dyja përdorimet; më tej, për të treguar vetëm gjatësinë e zanoreve përdoret vijëza horizontale (˘) mbi to;
2. Shkronjat (= grafemat) që janë të përbashkëta me italishten, shqiptohen në të njëjtën mënyrë. Përpos rasteve kur *c* do të ketë tingëllimin gutural [= /k/ = shq. let. <k>] para *a o u r*, në çdo pozicion tjetër do të tingëllojë si dhëmbore [= afrikate /ç/ = <ç>], sikurse *çfut* [= /çfut/] “çifut = it. giudeo”, *socm* [= /soçm/] “i sotëm = it. odierno”, *pac* [= /paç/] “paç = it. ebbi”. Në rast se shfaqet gjetkë [d.m.th. në të tjera pozicione] si guturale, kjo shkronjë do të zëvendësohet me *k* e do të shënohet gjithmonë [si <k>] pas *sc* [= /s/ = shq. let. <sh>] sa herë që shfaqet si e tillë;
3. një *r* e thjeshtë shqiptohet shumë e butë në një mënyrë që bën të dëgjohet një *e* [= /ə/ = shq. let. <ë>] para *r*, e për këtë duhet të jemi shumë të kujdesshëm për të mos përfutur keqkuptime të rëndomta;
4. *h* është gjithmonë e aspiruar, qoftë edhe e paraprirë nga bashkëtingëllore të tjera.

Në rrokjet [= grafitë] *chi* dhe *ghi* kemi një tingull aq të çjerrë e të hollë, që i afrohet (it.) *ci*, *gi* [= /tʃ/, /dʒ/ ≠ shq. let. <q>, <gj>]; kur nuk duhet të jetë një tingull i tillë përdoret grafia *ki* [= /ki, kj/ = shq. let. <ki, kj>].²³

5. *sc* [= /s/ = shq. let. <sh>] shqiptohet si te fjalët italiane *scendi*, *scinde*, edhe kur gjendet para një bashkëtingëlleje tjetër qoftë kjo edhe *h*. Kujdes!: *schyp* shfaqet si *sc-hyp* (= /shqyp/ “shqip”) me *h* të aspiruar. Në rast se *sch* duhet të tingëllojë si në italishten *shedola*, *schifo* [= /skedola, skifo/], atëherë do të shkruhet *sck* = <sck>, sikurse *pisck* [= /piʃk/] “copëz, it. pizzico”, *s[c]kièlm* [= /ʃkièlm/] “shqelm; it. calcio”. E njëjta thuhet për *sg*, që i përgjigjet ekzaktësisht *j* [= /ʒ/] në frëngjishte, sikurse: *sgghiet* “shigjetë” d.m.th. <sg-ghièt> [= /ʒjjet/]. Ndërsa *sg*h do të ketë tingëllim gutural sikurse në it. *sgherro* /zgerro/.

²³ Kemi të bëjmë këtu pas gjithë gjasash me përshkrimin e mbylltoreve palatale [c] dhe [j] të shqipes, të cilat nuk kanë gjegjëset përkatëse në italishte dhe që në të folmen katolike të Shkodrës shfaqen me variante afrikate, si tipike në gjuhë

6. Në rast se në fillim, në mes ose në fund fjale gjenden dy *n*, dikush bën të dëgjohej pas së parës një tingull i lehtë si *d*. Po kështu, kur ndodhen dy *m* që bëjnë të dëgjohej pas së parës një tingull si *b*;
7. Së fundi shkronjat [= grafemat] që ndryshojnë prej italishtes janë:
Ξ ξ, d.m.th. *d* [= frikative], e përfutur me gjuhën ndërmjet dhëmbëve [= /ð/ = shq. let. <dh>] si *δ*-ja greke, ose *th* e nyjës *the* në anglishte [= /θ/ = shq. let. <th>];
Λ λ [= /λ/ = shq. let. <ll>] d.m.th. *l* dyfishe dhe e ngulmët.
Σ ε [= /z/ = shq. let. <z>] d.m.th. *s* e butë si në frëngjishte;
Υ υ [= /y/ = shq. let. <y>], d.m.th. *u* e mprehtë si në frëngjishte." (= <Avvertimento>, f. 8-11)²⁴

Vëzhgime paraprake

Vërejtjet e mësipërme lidhur me kodin alfabetik, të ndërmarra prej autorit tonë e të pasqyruara në vepër vetëm në versionin italisht, lejojnë të përcillen tash si tregues domethënës për destinacionin e tyre thjesht dhe vetëm për misionarët e huaj (italishtfolës a -njohës) që mund dhe duhej të misiononin në Shqipëri, e për këtë arsye e kishin të nevojshme, në mos të detyrueshme, njohjen e shqipes së folur e të shkruar të kohës. Gjithsesi, përditësimi me shkrimet shqipe bash në këtë periudhë (Basile 1845; Radoja 1862; 1876), në të cilat mungojnë tërësisht vëzhgimet hyrëse të

²⁴ Per ciò che riguarda la pronunzia dell'albanese, si legga appunto come sta scritto, avvertendo intanto che:

1. L'accento grave (`) serve alla prosodia delle voci polisillabe, il circonflesso (^) fa profferire nasale e alquanto allungata quella vocale su cui si nota. Che se in una parola si trovino uniti, faranno entrambi il loro ufficio, se però vi sia il solo circonflesso, servirà esso ad ambi gli usi; per indicare poi il solo allungamento delle vocali si fa uso della lineetta (- -) orizzontale sulle medesime;
2. le lettere che son comuni con l'italiano , si pronunziano al modo stesso. Senonchè il *c* avrà il suono gutturale avanti *a o u r* , in ogni altro luogo sonerà dentale, come: *Cfut* giudeo, *socm* odierno, *pac* ebbi. Che se anche altrove dovrà profferirsi gutturale, sarà sostituito dalla *k*, la quale altresì noterassi dopo *sc* quando occorre;
3. una *r* semplice si pronunzia molto dolce in modo da far sentire un' *e* avanti *r* , e in ciò si stia molto attento , per non dare in equivoci grossolani ;
4. la *h* è sempre aspirata, sia sola sia preceduta da altre consonanti. Nelle sillabe *chi* e *ghi* ha un suono così schiacciato e sottile che si avvicina al *ci* e *gi*; quando non deve essere tal suono, si noterà *ki*;
5. la *sc* si pronunzia come nelle voci italiane *scendi scinde* , ancor- [f. 10]chè si trovi innanzi ad altra consonante e fosse pure *h*; imperò *schyp* si profferisce *sc-hyp* con *h* aspirata. Che se *sch* dovesse suonare come in italiano *shedola*, *schifo*, allora si scriverà *sck* , come *pisck* pizzico, *sckièlm* calcio. Lo stesso si dica di *sg*, che corrisponde esattamente all' *j* francese, come *sgghiet* (saetta) cioè *sg-ghiè*. Ma *gh* avrà suono gutturale come in italiano *sgherro*.
6. quando in principio , in mezzo, o in fine di parola trovansi due *n*, alcuni fanno sentire dopo la prima un leggiero suono di *d*. Così pure quando trovansi due *m* fanno sentire dopo la prima il suono di *b* ;
7. finalmente le lettere che differiscono dall' italiano sono:
Ξ ξ, cioè *d* profferito con la lingua fra i denti, come *δ* greco, o *th* nell' articolo *th* inglese ;
Λ λ, cioè *l* doppio e bleso.
Ε ε, cioè *s* dolce alla francese;
Υ υ, cioè *u* acuto alla francese.

kësaj natyre, na lejojnë të mëtojmë, qoftë edhe *ad hoc*, emrin e Guagliata-s, si dorëzanësin më të parë të atij kodi alfabetik dhe norme ortografike, që dëshmojnë thujtë përgjithësisht botimet, qofshin këto edhe ekleziastike, në gjysmën e dytë të shek. XIX në Shqipërinë e Veriut. Afria dhe ndryshimet e këtij kodi dhe të kësaj norme me simotrat e veta në shekujt pararendës duan kuptuar në këtë mënyrë për arealin në fjalë thjesht dhe natyrshëm si vijim i traditës, përkatësisht si risi të shek. XIX në kulturën e shkrimit shqip. E të dyja këto pamje i kemi fokusuar në vëzhgimet tona gjatë leximit të vërejtjeve të Guagliata-s sikurse edhe në shënimet tona për tekstin shqip të doktrinës së tij në përgjithësi:

a) Traditë dhe risi në kodin alfabetik

Vijimi i traditës disashekullore në kodin alfabetik është:

- i dukshëm dhe i qartë në pikën nr. 7 të vërejtjeve që bën autori lidhur me shkronjat e veçanta të tipit jolatin që kishin zënë vend qëmoti në kod: $\Xi \xi$ [= /ð/ = shq. let. <dh>] krahas $\Xi \Xi \xi \xi$ [= /θ/ = shq. let. <th>]; $\Sigma \varepsilon$ [= /z/ = shq. let. <z>] dhe $\var�$ [= /y/ = shq. let. <y>] (Buzuku, Budi, Bardhi) dhe $\Lambda \lambda$ [= /l/ = shq. let. <ll>] (Bogdani etj.)
- i përgjithësuar, si vijim i kushtëzuar i sistemit grafik të italishtes, në pikën nr. 2, ku nënkuptohen si shkronjat/grafemat ashtu edhe nyjëtimi i atyre tingujve/fonemave që shqipja i ka të përbashkëta me ortografinë e ortoepinë e italishtes.
- Ndonjë veçori e rastit saktësohet në pikën nr. 4, ku bëhen vërejtjet përkatëse lidhur me përdorimin e shkronjave/grafemave (me bazë latine) *h* dhe *chi, ghi* [= /h/, /ç/, /j/ = shq. let. <h>, <q>, <gj>] si karakteristike të shqipes.

Risite në kodin alfabetik duan parë, ndër të tjera, edhe si stabilizim në kod i shpërndarjes së alografeve të mëparshëm, duke mënjanuar në këtë mënyrë zgjidhjet e dikurshme alternative që lejonin shmangie në leximin, shkrimin, përkatësisht shqiptimin korrekt të fjalë(forma)ve përkatëse në *Koinenë Letrare Gege* të kohës. Ndër to veçojmë:

- shpërndarjen alografike të sistematizuar për shkronjën *c* me vlerat funksionale /k/, /ç/ (pika nr. 2) dhe /q/ (pika nr. 4), përkatësisht ndërndërrimin e saj me shkronjën *k* vetëm në raste kolizioni grafik (pika nr. 2), që mund të shkaktonin pasiguri në lexim dhe në shqiptimin korrekt;
- përdorimin e digrafit *sc* vetëm për të shenjuar fonemën /sh/, pra pa shpërndarje alografike në varg (: /sh/ ~ /sk/ ~ /shk/) si dikur.

Si risi të mirëfillta në kod lejohe mi të njohim:

- normalizimin e theksit të rëndë (pika nr. 1) për të nxjerrë në pah vetëm rrokjen nën theks të fjalëve shumërrokëshe, e jo si më parë – ndikim ky i dukshëm i ortografisë së italishtes e aspak i volitshëm për shqipen – për të vënë në dukje

kryesisht shkallën e hapjes së zanores (sidomos atë të shkurtër fundore në fjalët njërrrokëshe);²⁵

- përdorimin e theksit majërrethor (^: pika nr. 1) si mjet grafik për shenjimin e hundorësisë e (në raste kolizioni) edhe për gjatësinë e zanoreve si tipare korrelative të sistemit zanor të gegnishtes, një dukuri kjo që nuk kishte gjetur zgjidhje grafike fatlume më parë.²⁶
- përdorimin e vijëzës mbi një zanore (pika nr. 1) si mjet grafik për shenjimin e gjatësisë së zanoreve, një tipar tjetër korrelativ i sistemit zanor të gegnishtes, i njohur edhe te autorët e vjetër gegë, që përdorin rregullisht dyfishimin e zanoreve si mjet grafik. Shtojmë këtu që, megjithëse sinjalizohet (përpos rastit të mësipërm) si mjet i ri grafik, gjatësia e zanoreve sendërtohet thuajse gjithkund në tekst – sikurse edhe në tekstet e autorëve të tjerë të shek. XIX – me dyfishimin e zanoreve, një përdorim ky që ndoshta edhe për arsye teknike të shtypit vijon të gjëllijë përgjithësisht në botimet shqipe të shek. XIX e më pas.²⁷

b) Traditë dhe risi në normën ortografike

Duke dhënë që në fillim kumtin e tij: “Sa i përket shqiptimit të shqipes, [ai] realizohet pikërisht ashtu siç shkruhet”, autori ynë i bën me dije lexuesit sqimatar kriterin themelor të normës ortografike dhe ortoepike sado rudimentare, të cilën ai – sikurse përgjithësisht autorët e letërsisë ekleziastike të Veriut në shek. XIX – rreket të zbatojë me konsekuencë në tekstin shqip. Bëjmë fjalë këtu për zbatimin e vetëdijshëm të parimit fonetik/fonologjik, të cilin shumëkush mund ta kundrojë sot – pa kurrfarë mëdyshjeje të rastit – si vazhdimësi e traditës në kulturën e shkrimit shqip (të Veriut) në shek. XVI-XVIII.

Asgjëmangut një lexim sado i përciptë i “Avvertimento-s” së autorit lejon të perceptohen shpejt dhe saktë risitë, përkatësisht ndryshimet e dukshme ndaj normës ortografike që zbatohet në tekstet e mëhershme. Prashtu, përpos përdorimit të stabilizuar të theksave si mjete grafike (pika nr. 1), sikurse përkujdesit të sinjalizuar ndaj shqiptimit korrekt të disa grafemave dhe alografeve (në pikat e tjera), tërheqim vëmendjen në këtë rast sidomos për pikën nr. 6, ku autori vë oroe të veçantë lidhur me nyjëtimin, përkatësisht tingëllimin sqimatar të bashkëtingëlloreve dyfishe *nn*, që “dikush bën të dëgjohet pas së parës një tingull i lehtë si *d*” dhe *mm* “që bën të dëgjohet pas së parës një tingull si *b*.” Në të dyja rastet kemi të bëjmë me asimilimin e togjeve bashkëtingëllore /nd/ dhe /mb/, një tjetër dukuri kjo, që këtë kohë duhej të

²⁵ Bogdani (1685) përdor theksin e rëndë edhe si mjet grafik për të shënuar zanoren e patheksuar qendrore [ə] = <è> = /ë/, por me këtë risi solli më fort konfuzion në shkrimin e shqipes, andaj edhe s’gjeti shumë përkrahës ndër lëvruesit e mëvonshëm, përkatësisht nxiti syresh që të kërkonin dhe gjenin zgjidhje të tjera grafike, khs. Kazazi (1743): <æ> = [ə] = /ë/. Shih më hollësisht Bardhyl Demiraj: Gjon P. Nikollë Kazazi dhe “Doktrina” e tij. Shkodër 2006.

²⁶ Bogdani tentoi si zgjidhje grafike përdorimin e shkronjës <n> si mjet grafik për shenjimin e hundorësisë së zanoreve, por shkaktoi edhe në këtë rast më shumë konfuzion, andaj edhe nuk pati përkrahës të mëvonshëm.

²⁷ Khs. ndër të tjerë fjalorin e Shoqërisë “Bashkimi” (Shkodër 1908).

kishte hyrë në fazën e vet përfundimtare në mos në gjithë hapësirën gegnishtfolëse, të paktën në të folmet e gegnishtes veriperëndimore me qendër urbane Shkodrën.

Një tjetër rrethanë, thënë më saktë mungesa e saj në “Avvertimento-n” e autorit tonë, i hap udhë përsiatjes sonë – paksa të guximshme! – lidhur me një “risi” të ndërmarrë vetëdijshëm prej tij, sikurse përgjithësisht tek autorët e letrave (ekleziastike) shqipe të Veriut përgjatë gjithë gjysmës së dytë të shek. XIX, madje edhe më pas, të paktën në fillimet e shek. XX.²⁸ Le të tërheqim kështu vëmendjen për mungesën e një “pike” të numëruar ashtu veças, të cilën mund e duhej të sqaronte autori ynë për shkrimin ase shqiptimin e së ashtuquajturës <e-ja e pazâne> në gegnishten letrare të kohës, thënë ndryshe të “mollës së sherrit”, ku dhe si ka përfunduar debati albanologjik sa shkencor aq edhe diletantesk i kohës sonë, kur shumëkush zë veshët me dyllë ndaj britmave në varg të *Kalorësve* të vonuar të *Gjuhës Letrare Kombëtare të Njësuar Shqipe*, të cilët edhe pse tash kanë ndërruar lëkurë, duke folur e shkruar vetëm për *Shqipen Standarde*, nuk e harrojnë assesi zakonin e vjetër të kaçakëve të malit me qenë gjithmonë gati për sulm e për mbrojtje e me iu qepur rishtas shpellave dhe gërxheve, në rast se Këshilli Ndërkademi Shqiptar guxon të legjitimojë një ditë të bukur ditësh që *kalë* – emri i tyre më i preferuar! – të mos shkruhet më me <e-në e pazanë> në fund të temës.

Mungesa e kësaj pike të veçantë në vërejtjet e autorit tonë përkon kryekëput kumtin e tij nistor: “Sa i përket shqiptimit të shqipes, [ai] realizohet pikërisht ashtu siç shkruhet”, çka vjen vetëm me thënë: me mungesën e “e-së së pazanë” në shkodranishten e asaj shtrese sociale (katolike) të kohës, andaj mungon natyrshëm edhe në tekstin shqip të doktrinës, sikurse edhe në tekstin e njëkohshëm shqip të P. Vincenz Basile-s (1845) e përgjithësisht në tekstet e Engjëll Radojës (1862, 1876) e gjetkë.

Vëzhgimi ynë i mësipërm, të cilin lexuesi vetëm do ta tumirë, në rast se u hedh një sy sado përciptas faksimileve që i janë bashkangjitur në fund këtij studimi, i shton një argument më shumë përsiatjes sonë lidhur me *Risinë e Shekullit XIX* që ndërmorën në mënyrë të vetëdijshme autorët tanë të Veriut në këtë periudhë: Bëjmë fjalë këtu bash për ligjërimin e thjeshtë e popullor të Shkodërloces dhe në Shkodërloce si qendra kryesore urbane e kulturës qytetare shqiptare në shek. XIX, e cila përthithi si magnet pendën e elitës intelektuale-fetare vendase të kohës, e për rrjedhojë u vu në bazë të shkrimit letrar e të përkujdesur shqip.

Motivin e këtij ndryshimi të paradigmës në normën ortografike gegnishte të kohës, në fakt vetëm e përjetojmë, duke mos e ndeshur assesi të thënë e shkruar ashtu troç në “Avvertimento-n” vetëm italisht të autorit tonë, pra në atë pjesë, të destinuar si e tillë vetëm për lexuesin e huaj joshqipfolës. Gjithsesi, këtë motiv e kërkojmë dhe e gjejmë si të tillë tjetërkund e te tjetërkush: bash në pendën dhe autoritetin e sinorvënësit të filologjisë shqiptare, shi të At Engjëll Radojës, kur shkruante dikur në letër të bardhë parathënien e ribotimit të tretë të tekstit shqip të Kuvendit të Arbënit (1872), veçse këtë radhë të përkthyer prej tij për një arsye në dukje të thjeshtë, thuajse triviale:

²⁸ Për krahasim mund të përcillet gjithashtu fjalori i Shoqërisë “Bashkimi” (Shkodër 1908).

“Nuk t’ thom se n’ ket libr [= Kuvendi i Arbënit 1706, 1868² – B.D.], shkruë mjeshtrisht prej Vinçenc Zmajevikut, arçipeshkvit t’ Tivarit, knohen fjal t’ rea, t’ moçme e t’ zgiedhuna. Besa une, si flasim shqypen n’ Shkodr, ashtu me t’ paken forc temen jam munue me shkruë, tuj çalltis, nderi ku kam mujt, m’ u shporr fjalvet t’ giuhvet t’ huejavet, e tuj bā gajret edhe çì fjal, çì knohen ktu, t’jën marrun vesht prej Shqyptarit soçm.”²⁹

Është bash “t’ marrunit vesht prej Shqyptarit soçm” ai tharm ngjizës dhe motivues që përjetojmë ndërkohë gjithkund në kulturën e shkrimit shqip edhe të shek. XIX në arealin kulturor të Veriut e që e bën tash të tepërt shtjellimin në detaj të një pyetje-përgjigjeje të fundit të mundshme në studimin tonë modest mbi veprën e parë gegnisht që datohet në këtë shekull :

- Përse *nuk* u ndoq edhe në shek. XIX në veri të hapësirës kompakte shqipfolëse ajo traditë fanmirë në kulturën e shkrimit shqip të shekujve të mëhershëm? =
- Sepse u ndoq edhe në shek. XIX në veri të hapësirës kompakte shqipfolëse ajo traditë fanmirë në kulturën e shkrimit shqip të shekujve të mëhershëm.

Parë nga kjo perspektivë “Doktrina e Kershten” e siarbëreshit Àt Zef Ignazio Guagliata ruan dhe përcjell edhe në kohën tonë admirim dhe stimë tek ata që dinë ta shkruajnë, ta lexojnë e për më tepër ta duan mirëfilli shqipen e shkruar në hullinë e pacak e të pafund të standardizimit të saj.

²⁹ Versioni origjinal: „Nuk t’ëxom se n’ket libr, sckruë miesctriscet prei Vincenz Zmajevikut, arcipescckvit t’ Tivarit, knohen fial t’ rea, t’ moccme e t’ εghiëξuna : bessa une, si flassim Scciγpen n’ Sckodr, asctù me t’paken forz temen jam munue me shkruë, tui cialtis, nderi ku kam muit, m’u scporr fialvet t’ ghiuhvet t’ huejavet, e tui bāa gairet, eçè ci fial, ci knohen ktù, t’ jeen marrun vesct prei Scciγptarit soccm.” (KA³ 1872: *Knuesit, mikut, t’ dashtunit*)

Faksimile të veprës së Petër Zef Guagliata-s

DOTTRINA E KERSCTËN
CARDINÀLIT BELLARMINO

T' SCIOCHNIËT JESUS

CSI È A UN N' SCHËP

PREI P. ZEFIT GUAGLIATA

T' SCIOCHNIËT EVËT.

N' ROM

TE STAMPÛEMIN T' SCËTIT CUVËN DE PROPAGANDA FIDE

1845.

T' CONSECRÙOMIT.

O lumnùoscm e ngusclùoscm apòstul i Indit sc' Francèsk Xavèri , ti mme gni cel fort i neçun punnòve me mpsue dottrinen e kersctén : ti praa mer ket libr nnen t' dälunin-çot tan : tæ mã mir se tiètrit do t' sciugròhet. Nnimò ežè ghižž atà chi munnòhen me mpsue dottrinen : jep atènvèt t' durim , cel , t' chindrim n' ket vièvs-
scm cannàt. Scikiò mme sž t' dàsctun fmiit : sctiè n' crahnòrin atènvèt dascctniin e ghižžmònsçme me zan dottrinen e scéite. Ah ! ti e di c' frèite e jets e pà-sosme jep n' vakt vet dieia e scéites fees on temellùeme kiçsc n' voghliin n' çemrat e fmivèt. Por ežè dièlmit e varçat e Schçpnäis kàn idiaàa , si e patne t' dasctnùsçmit fmiit e Indit : ežè kta jan mierisct

nner ereticht , turchit, gentilt , t' zilt
tnoin me prisc feen e me fligh ves-
set. Ah fort i fort vecchil e missiò-
nevet ! O ti nkææe kta pâ-fee, o forzò
n' religiònin t' catolicht , o mâ mir
bân t' dææ basck kto pun , tui chit
gmî sckinnii e selit tan fort i neæun
n' scpirtin atænvet , chi marrin mrapa ,
nnonse largh miàft , ghiærmæ tuja
e apostuòscm. Oh c' cunòr e lumnùo-
scme kena me bâ tæ ktu n' æee tui
t' mar mrapa , e masannèi n' chieæ
tui t' gæue ! Po, ti mme t' canscium
na e jep ; na mme ghiææ fuchii e
scpnnessòim. Asctù kiòft.

« Une mirfilitt ææom, se sciùm nner
» atà , chi dnohen n' munnimmet pa-
» sòsm, schoin nn' at sckretii e ghiææ-
» mònsçme , persè s' diin temèllet e
» fees , t' zillt ghiææ do t' diin e t'
» bessòin per m' u basckùe mme t'
» sghiææunit n' parrís. »

BEECÙEM I CATTERMÆÉTI.

T' HÏMIT.

PVETUN. Scka âsct dottrina e kersctèn ?

GEVAP. Dottrina e kersctèn âsct gni t' mlèxunit cafscvet , chi Jesu Cristi na mpson per m' u scelbùe.

P. Saa jan pièst e dottrins e kersctèn ?

G. Pièst e dottrins e kersctèn jan catter , do me řřan : *Bessòima* , *Atèna* , řet urřnimet e Tinsòt e sctat sacramènet.

P. Psè pièst mà t' parat e dottrins jan catter as mangut as teper ?

G. Pièst mà t' parat e dottrins jan catter , persè catter jan cafscet e nevòiscme per m' u scelbùe.